



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 87 DATE 11/2022

“PËR RISHPËRNDARJEN E TVSH-SË NË BUXHETIN E PROJEKTIT: “ZHVILLIMI EKONOMIK ALTERNATIV NË ZONAT ME RISK TË LARTË TË VEPRIMEVE ILEGALE/INFORMALE SI MBJELLJA E KANABISIT NË GJIROKASTËR DHE DROPULL”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 04.11.2022 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për rishpërndarjen e TVSH-së në buxhetin e projektit: “Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve” i ndryshuar, VKB nr 107 datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr 06, datë 18.02.2022 i ndryshuar”.

VENDOSI:

1. Të miratojë rialokimin e buxhetit të mbetur pas procedurave të prokurimit si më poshtë

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 “TVSH Rikonstruksioni i objektit për ta kthyer në qendër multifunkionale” tepëricë në vlerën 484,083.2 Lekë

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 “TVSH Ngritja e dy parcelave për të shërbyer si herbarium” tepëricë në vlerën 324,071.4 Lekë.

Shtohet:

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 TVSH “Fotovoltaik” në vlerën 200,000 Lekë.

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 TVSH “Paketim për bimët medicinal të branduara” në vlerën 100,000 Lekë.

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 TVSH “Mjet kamioncine për transport të bimëve medicinal” në vlerën 200,000 Lekë.

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 TVSH “Ekspozita bimëve” në vlerën 162,649.2 Lekë.

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 TVSH “Pajisje elektronike” në vlerën 46,228.8 Lekë.

Gr.00 Tit. 04130 Kap.4 Art 231 “TVSH Mobilimi i qendrës multifunkionale” në shumën 99,276.4 Lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

AVDI HASANI

